

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, Gjyqtari individual Liridon Maloku, në çështjen juridike të paditëses NTP ["M..."] me seli në Prishtinë, kundër të paditurës ["C..."] nga ... - Kroaci, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës të ushtruar nga paditësja, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës Ae.nr.260/18 e dt.16/11/2018, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.8/17 e dt.01/10/2018, me datën **08/03/2019**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pa themeltë propozimi për përsëritjen e procedurës e ushtruar nga paditësja NTP ["M..."] me seli në Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës Ae.nr.260/18 e dt.16/11/2018, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.8/17 e dt.01/10/2018.

### **A r s y e t i m**

Paditësja NTP ["M..."] me seli në Prishtinë, me datën 14/12/2018, ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës në gjykatën e shkallës së parë, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës Ae.nr.260/18 e dt.16/11/2018, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.8/17 e dt. 01/10/2018, me arsyetimin se pretendon se janë paraqitur prova të cilat gjykatat nuk i ka marr për bazë, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovon propozimin dhe të lejon përsëritjen e procedurës si dhe të anulon aktvendimet e atakuar.

Përgjigje në propozim ka paraqitur e paditura, duke i propozuar Gjykatës që të refuzon propozimin për përsëritjen e procedurës si të pa bazuar në ligj.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, me kujdes të shtuar bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës, në harmoni me dispozitat e nenit 239 paragrafi 1 e lidhur me nenin 235 të LPK-së dhe pas vlerësimit të thënieve të paraqitura në propozim, gjeti se:

#### **- Propozimi është i pa themeltë.**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar në dispozitivit ka vendosur të hedh si të pa lejuar padinë e paditëses NTP ["M..."] me seli në Prishtinë, kundër të paditurës ["C..."] nga ...-Kroaci, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së palës paditëse ka marr aktvendim Ae.nr.260/18 e datës 16.11.2018, me të cilin e ka refuzuar si

të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.8/17, e dt.01/10/2018.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, pas analizimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, në raport me pretendimet e paditëses për përsëritjen e procedues, të cilin propozim nuk e ka bazuar në dispozitën ligjore të nenit 232 të LPK-së, por nga përmbajtja e propozimit lehtësisht mund të kuptohet se propozimin për përsëritjen e procedurës e bazon sipas shkaqeve të paraparë me nenin 232 pika g) e LPK-së, andaj Gjykata erdh në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara që të lejohet përsëritja e procedurës në këtë çështje juridike, për këto arsye si vijon:

Pala paditëse përmes propozimit për përsëritjen e procedurës nuk ka paraqitur ndonjë provë të re për të vërtetuar pretendimin e saj se në këtë rast juridik ekzistojnë kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës të parapara me nenin 232 pika g) të LPK-së, sepse të gjitha pretendimet e paditëses janë trajtuar me profesionalizëm të lartë nga Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës dhe me të drejtë kanë ardhur në përfundim se ekziston gjyqëvarësia-litespendenca si pengesë procedurale për të proceduar me tutje lidhur me padinë e paditësit, për shkak se për të njëjtën çështje juridike, paditësi ka ngritur padi ndaj të paditurës dhe është duke udhëhequr procedurë e njëjtë kontestimore ndaj subjekteve të njëjtë procedural dhe atë sipas shenjës III.EK.nr.466/15 e datës 03/01/2018, e që sipas shkresave që gjenden në lëndë rezultojnë se lënda gjendet në procedurën ankimore pranë Gjykatës së Apelit e Kosovës.

Gjykata e Apelit konform nenit 239 paragrafi 1, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar përsëritjen e procedurës.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**  
**EN.nr.3/19, me datë 08.03.2019**

**Gjyqtari individual**  
**Liridon Maloku**

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, prej ditës së dorëzimit, trupit gjykues të Gjykatës së Apelit sipas neni 240.4 të LPK-së.